

Praktika Mësimore

Kodi i lëndës	Semestri	Kreditet e lëndës				Kredite
		Leksione	Ushtrime/ Seminare	Laboratore	Praktikë mësimore	
	VI	-	-	-	4	4
Sasia e orëve: auditor/ jashtë auditorit		-	-	-	92/8	92/8
Sasia e orëve: Total		-	-	-	100	100

Objektivat e lëndës

Praktika mësimore ka për qëllim të ofrojë, për studentet para diplomimit, marrjen e njohurive në mjedisin e punës, duke punuar me një specialist të kualifikuar të fushës, për të rritur efektivitetin e përfitimt të njohurive praktike. Praktika synon të nxitë motivimin për profesionin e inxhinierit, të nxitë bashkëpunimin me grupet e specialistëve të fushave respektive, të ndihmojë në zhvillimin e aftësive profesionale dhe nga ana tjetër, ti japë studentit mundësinë të përgatitë një diplomë origjinale, të konkretizuar. Praktika krijon një mundësi për t'u punësuar në të ardhmen, në vendet e mundshme të lira, pranë kompanive institucioneve, organizatave respektive.

Njohuritë dhe aftësitë që përftohen nga përvetësimi i praktikës mësimore

Praktika zhvillohet në semestrin e dytë, në vitin e tretë, në 3 - 4 javë, pranë kompanive, institucioneve apo organizatave, aktiviteti i të cilave mbështetet në teknologjitë e lidhura me fushat përkatëse Inxhinierike.

Me fitimin e krediteve të saj studenti duhet të jetë i aftë:

Të orjentohej drejt dhe në mënyrën e duhur në tregun e punës në kompanitë, institucionet, organizatat aktiviteti i të cilave lidhet apo mbështetet në teknologjitë e fushave përkatëse Inxhinierike.

Të njohë organizimin e kompanive, institucioneve apo organizatave. Të kuptojë rëndësinë e rregullave të sigurisë, rregullave të punës, detyrave dhe të drejtave që rrjedhin prej legjislacionit përkatës dhe rregulloreve të brendshme të funksionimit të kompanive organizatave apo institucioneve përkatëse.

Të punojë në grup dhe në mënyrë të pavaruar; të respektojë rregullat e sjelljes dhe të etikës profesionale, të jetë i hapur ndaj diskutimeve profesionale, të ruajë sekretin profesional dhe informacionet konfidenciale të lidhura me sistemet apo proceset specifike; të kuptojë rëndësinë e inisiativave, detyrave dhe riskut që rrjedh prej zbatimit të tyre.

Të përdori dhe thellojë njohuritë e marra në shkollë, për përdorimin e tyre efikas në sistemet praktike të lidhura me sistemet elektronike, rrjetat e kompjuterave, rrjetat e telekomunikacioneve, protokollat e transmetimit të të dhënave, sistemet e kontrollit dhe sinjalizimit, shtresëzimin e sistemeve, protokollat e komunikimit, implementimin e rregullave/protokolleve të sigurisë së informacionit.

Të konceptojë: sistemet dhe proceset inxhinierike në tërësi, mënyrën e funksionimit të tyre; ndërthurjen e hardwerit me softwarin përkatës; mënyrën e operimit dhe mirëmbajtjes së sistemeve; nevojën për identifikimin e riskut dhe minimizimin e tij; llogaritjen e kostos së projektimit, implementimit, operimit dhe mirëmbajtjes.

Të kryejë, kur është e nevojshme, analizën teorike/analitike të problemeve dhe interpretimin e fenomeneve që lidhen me ecurinë dhe përpunimin e sinjaleve në sistem dhe mjedisin e transmetimit; të konceptojnë sjelljen e elementeve fizikë/elektronike si dhe sjelljen e elementeve llogjikë/software të sistemeve gjatë proceseve të ndryshme.

Të identifikojë problemet, ti raportojë ato në mënyre profesionale; të konceptojë arsyet e ndodhjes së problemit dhe llogjikën teknike, analitike, profesionale të zgjidhjes së tyre.

Të kryejë, kur është e nevojshme, nën mbikqyrjen e specialistëve të fushave respektive inxhinierike, planifikimin, projektimin, simulimin dhe zbatimin e projektit për pjesë të sistemeve; instalimin, konfigurimin, vënien në punë dhe testimin e pajisjeve, sistemeve apo pjesëve përbërëse të tyre, pasi të ketë kaluar me parë hapat e konceptimit dhe analizës së sistemeve apo pjesëve të tyre përbërëse.

Vendet e mundshme për zhvillimin e praktikës

Studentët, mund të kryejnë praktikën pranë kompanive, institucioneve dhe organizatave, aktiviteti i të cilave mbështetet në teknologjitë e lidhura me fushat e Inxhinierisë Elektronike dhe Inxhinierisë së Telekomunikacionit.